ADEM ZAPLLUZHA

ISHIM TË LUMTUR SI GJINKALLAT

Redaktor:
Bedri Neziri

Recensent:
Zyba Hysa

Lektor:
Veli Veliu

ADEM ZAPLLUZHA

ISHIM TË LUMTUR SI GJINKALLAT

"TREND"
2017

PARATHËNIE

RECENSION PËR LIBRIN “ISHIM TË LUMTUR SI GJINKALLA”

“Letërsia është fantazi, por jo pjellë e një fantazie, është pjellë e një realiteti , për të ndritur udhën e drejtë një realiteti tjetër në të ardhmen...”

Zyba Hysa

Poezia është pasqyra e shpirtit të botës, shtimi dhe perfeksionimi i saj, tregon se plagët e botës janë në rritje, rënkimet e brengave çajnë qiellin, godasin Zotin dhe Zoti për t'i shpëtuar dhimbjes, shkarkon si muzë tek poetët, bijtë e tij hyjnorë, për të lëshuar peshën e dhimbjes në letër përmes vargut të poezisë... Poetët janë bijtë e Zotit, pa të cilët edhe vetë Zoti s'do të ekzistonte prej dhimbjes së plagëve të njerëzimit...

Më ndodh shpesh të lexoj poezi... diku një varg e s'bën zemra më tej, diku deri në mes e ndërpres, rrallë më ndodh të lexoj poezitë deri në fund, por atë që lexoj deri në fund, i rikthehem për të dalluar mirë çfarë fshihet thellësive të saj…gjë që më ndodhi në poezitë e vëllimit poetik "ISHIM TE LUMTUR SI GJINKALLAT".Kur e fillova,s’ndalova në vargun e parë, as në mes të poezisë, i dola librit në

fund me një frymë dhe thashë me vete: “Poezia është gulçima e një shpirti të robëruar… është flaka e lirisë së tij…”

Ju kërkoni të jem RECENSENTE e këtij libri, po a mundem unë? Le ta them me pak fjalë: Je poet i madh! Unë kurrë s’do të krahasoja me poetët e mëdhenj botërorë, siç bëhet rëndom në recensionet e librave, do të thosha, se poezia jote është e ADEM ZHAPLLUZHES dhe kjo të ka bërë nder të madh, të ka dhënë emrin POET.

Aq sa herë njihem me poetë të ndryshëm, po aq qëndroj dhe them me vete: “Ndodh kjo gjë në kombet e tjera?” Është e çuditshme: mund të jesh i burgosur, por shpirti mund të jetë më i lirë se në liri, mund të jesh i lirë e shpirtin mund ta kesh të burgosur. Kjo u shkon për shtat fjalëve të djalit të Prof. Dr. Isuf Luzajt, Kujtim Luzajt, kur e pyeta në një intervistë për librin studimor “Isuf Luzaj, Një Shtizë Diell mbi Atdhenë”, se ku ndjehej më mirë, në Shqipëri apo në Amerikë,ai u përgjigj: “Më i lirë isha në Burrel, me të dënuarit politikë! Atje trupi ishte i burgosur, por shpirti ishte më i lirë se ata që ishin jashtë dyerve të burgut, aty ishte ajka e Kombit, të gjithë intelektualët shqiptarë dhe bisedat me njëri – tjetrin e bënin shpirtin me krahë shpendi…”

Librin "ISHIM TË LUMTUR SI GJINKALLAT" të poetit shqiptar, me banim në Kosovë, Adem Zaplluzhës, meqë ishte pak i njohur nga unë si dhe nga befasimi që përjetova prej bukurisë së vargut poetik, më shtyri kureshtja të lexoja biografinë e krijimtarisë së

tij (për mua biografia e një krijuesi është kjo), ku mësova se kishte krijuar 149 vëllime poetike, një shifër marramendëse, që në shikim të parë, kush s'ka lexuar poezinë e tij, të jep atë përshtypjen e një mendimi, do të thosha pa bazë që qarkullon nga ata njerëz që kanë vakume mendimi dhe shpirti, se "Të shkruash shumë s'ka cilësi". Jo, kjo s'mund të përgjithësohet! Unë respektoj me përunjësi cilindo që shkruan dhe hesht duke i lënë kohës t'i vërë vulën veprës së tij, se ata që shkruajnë dhe ulërasin se çfarë kanë bërë, ndjejnë frikën e asimilimit të krijimtarisë së tyre nga KOHA.

E kam thënë edhe herë tjetër, koha është një sitë sizmike që kurrë si ndal lëkundjet duke shoshitur, ajo ndan krundet nga mielli dhe miellin sipas kategorive; për bukë, për petë, për ëmbëlsirë... Të mos merremi me kohën, ta lëmë të të merret ajo me ne, por të hedhim një vështrim tangent në këtë libër, ku është derdhur frymë për të dhënë frymën hyjnore lexuesit, ashtu siç bëjnë nënat që marrin një majë luge nga gjella për ta provuar, që lexuesit t'i shtohet dëshira

ta rrufitë poezinë e tij…

E përbashkëta e tematikës së poezisë shqipe, sot dhe përherë (përjashtojmë poezinë e realizmit socialist që i këndoi një dashurie fantazmë, që shfaqej me petka engjëlli, por që fshihte brenda satanan) qëndron mbi 2 shtylla; dashuria për Atdhe dhe dashuria për njeriun mbështetur në virtyte.

Të shkruash për Atdheun, duhet të njohësh plagët e tij, të ndjesh rënkimet e tij deri në palcë të shpirtit e shpirti gulçon e nëpër gulçime merr flakë poezia… Atdheu s'është thjesht një copë tokë e lënë trashëgim nga të parët, ai është burimi i frymëmarrjes sonë, është bërthama e kuanteve të shpirtit të njeriut, është tingulli i gjuhës, tingull që s'e gjen në asnjë gjuhë të botës, është ëmbëlsia e lindjes së diellit e pse dielli lind për gjithë tokën… është dëshira për tu prehur në gjirin e tij…

Një popull nga më të lashtët, një popull që mbart me vete cilësitë më fisnike njerëzore, ku barbarët e stepave çfarë s'kanë bërë ta zhdukin, ta shpërfytyrojnë, prapë se prapë u ka mbijetuar shekujve duke i lyer ata me gjak e gjer t'i zërë gjaku shekujt e të kuptojnë padrejtësinë e madhe që i është bërë dhe bëhet këtij Kombi evropian, ngulur këtu para se të vinin këta që sot na lënë jashtë Evrope, ne do përleshemi, do kacafytemi, por s'do të zhdukemi... Te jesh dikush është diçka, por të dish të qëndrosh, kur të gjithë të sulmojnë, kjo është e admirueshme... dhe kombi ynë është për tu admiruar me historinë e tij të lavdishme, janë për tu admiruar, ata bij të këtij kombi që me pushkë e me penë kanë vënë vulën e mos asimilimit të tij...
Në poezinë "Sa herë i shfletoj librat e vjetër" autori shprehet:

“Çfarë gabimi bëmë
Ku mëkatuam që kaq shtrenjtë
Po e paguajmë
Këtë heshtje tinëzare
Na u djegën ullinjtë nëpër fusha
Tok me drurët po kalben edhe rrënjët

Sa herë që i shfletoj librat e vjetër
Shoh se njëqind fytyra
Na paska historia
Deri në asht na e rropi lëkurën
Nëpër furrat e gëlqeres i dogjën hartat.”

Po kështu poeti na kujton autoktoninë tonë nga institucionet fetare para se të vijnë barbarët dhe luftërat e përgjakshme që ka bërë populli për të mbrojtur trojet tona e shpreh në pak vargje të poezisë “Presim zërin e Atdheut”:

“Pakëz më tutje në anën veriore
Muranat e një kishe të kahershme
Parmenda sërish i hap plagët e tokës
Dalin në shesh me mijëra ushtarë.”

Kush shkruan përtej shijeve të lexuesve dhe admiruesve të vet, ka shkruar për brezat që do të vijnë, ka shkruar për ardhmërinë e njerëzimit, ajo

që hidhet në letër, mbetet e pavdekshme nëse i reziston kohës.

Kam dëgjuar shpesh për famën që po merr Kadare nëpër botë, kjo pak e pabesueshme për mua, sepse një krijimtari, që të marrë përmasa universale (për vlera, jo për përkthimet dhe shpërndarjet e saj) patjetër duhet të ketë ndritur së pari kombin nga vjen ky, apo ai shkrimtar dhe forca e kësaj krijimtarie të jetë ndjerë në formimin e mendësive përparimtare të popullit nga vjen krijuesi që të reflektojë më pas në atë globale. Globi përbëhet nga shtetet dhe shtetet nga kombet, apo nga disa kombe, kështu edhe letërsia globale, përfshin letërsinë që u ka dhënë dritë këtyre kombeve, se të dërgosh qiri në xhami, kur s'ke në shtëpi, kësaj i thonë tjetër gjë; ose ke frikë zotin, ose t'i ka marrë zoti mentë...

Unë kam pasur një merak, që vargu i lirë ul muzikalitetin dhe ritmin poezisë, por një dorë e stërvitur mrekullisht me vargun, e ka shndërruar këtë poet në mjeshtër të vargut të lirë, ku përveç mesazhit, përmes figuracionit jashtëzakonisht të pasur, duke ruajtur një rimë dhe ritëm të brendshëm që më shumë ndjehet, se sa lexohet, sjell para nesh poezi bashkëkohore, e cila i shkapërthen kornizat e tradicionales, jo për tu shpërndarë pa drejtim, por për të krijuar kurorën e bukur të poezisë moderne shqipe.

Poezia e Ademit është sqimatare, ajo kërkon lexues të stërvitur me poezinë, lexues me kapacitet të lartë

intelektual, se ajo flet direkt dhe indirekt, ajo flet me vargjet, por edhe mes vargjeve, ai flet për të djeshmen e mbuluar, për të sotmen e turbulluar dhe për një të nesërme më shumë se e mbuluar, më shumë se e turbulluar... e megjithatë , ai përulet para origjinës së tij, origjinë e një populli trupvogël, por me histori të madhe, siç është kombi ynë...

“Kur të vij çasti i ikjes
Më vendosni në maje të një plepi
Ose diku te retë
Atje lartë
Përtej mjegullave nga zbritën të parët e mi...”, do shprehej autori në poezinë “Me dorën e djathtë ta preki diellin”
Më vjen mirë, që gjej të kristalizuar dhe mendimin që nxora, pasi bëra një studim një vjeçar mbi fatkeqësinë e copëtimit të trojeve tona, se zanafilla është pikërisht në Fushë- Kosovë, në betejën e vitit 1389. Po në vargjet e poezisë “…kërkon dhe gjen "Ycin" e historisë dhe rrokullimën e Kombit tonë, rrokullimë që e mori nga tradhtia e barbarëve serbë e bashkëpunimi i tyre me turqit. Ai ngre zërin që ashtu siç rriten selvitë mbi ato varre që i lanë pa identitet, se edhe varret u sillnin tmerr, të rritet gruri e të ushqehen filizat e këtij populli, pa qenë nevoja të ikim nga toka e begatë nëpër rrugët e botës...
Bukur do e paraqiste poeti në poezinë “Përkundi dhe rriti nga një plis”, ku me forcën e vargut, shkul

rrënjët e historisë së vërtetë. Diku e kam thënë se historinë me gjithë forcën e gjallësinë e saj, mund ta sjellin vetëm poetët e vërtet poeti Adem Zaplluzha e ka sjellë mrekullisht:

“Eh moj fushë e mirë e mëllenjave
Me lulëkuqe prej gjaku
Që në këtë tokë je ngulitur
Si një pykë
Sa herë që erdhën të huajt
Ti për mrekulli dite
Dhe u mbete në grykë
.....

Eh moj fushë e bozhureve
Kurrë nuk tu heq gazepi
Me shekuj kalërove mbi kuajt e luftës
Atdheu për ty ishte djepi
Që nga secili dru a lis
Për lirinë tënde
Përkundi dhe rriti nga një plis”

Një pemë që sulmohet vazhdimisht me gurë, ajo çdo vit prodhon më shumë... Ajo sulmohet në frytin, por jo në çeljen e gjetheve në lulëzim, edhe barbarët na kanë sulmuar për të na marrë të mirat materiale, por pa na zhdukur e shuar. Mbase ka ardhur në një pikë që barbarët kanë më shumë interes të na përdorin sesa të na zhdukin, të na lënë "të pavarur" se sa të pushtuar, kështu mishi piqet

dhe helli nuk digjet, zbatohet strategjia e kahershme e vjeljes së taksave dhe haraçeve duke vendosur spahillerë shqiptarë me gjak të qelbur..."shoh hijet e të gjitha maskave" masakrime të elitës, shpërngulje, shfrytëzim i të mbijetuarve... dhe ne qeshim dhe vallëzojmë pavarësinë, një pavarësi të varur me kokë poshtë…

“Më duket se stina kalon
Në një gjendje tjetër
Të pashpresë
Një pemë e egër pa shpirt dhe formë
Qëndron përballë stuhisë
Retë e shkapërderdhura
Bredhin fushave si drerët e egër
Nga sytë e lëbyrta të ditës
Pikojnë trishtimet e shirave
Një kohë e shpërdredhur zvarritet rrugëve
Nëpër pijetoret e qytetit
Shoh maskat e të gjitha llojeve
Rrugët fantazmë ëndërrojnë prenë
Nën qepenat e dyqaneve
Palosen ngordhësirat e tërë qytetit...”

Në një vend ku zhvillimi i tij shihet në vargun e gjatë të emigrantëve dhe xhepat e politikanëve, sundon e liga aq shumë, saqë për t'i shpëtuar asaj nuk mjafton më të sakrifikosh veten, se përsëri po e njëjta gjë do të jetë, ulur këmbëkryq janë maskat. Maska të pështira gjer në provokim të nxjerrësh

helmin e hipokrizisë që pimë çdo ditë. Kulmi i këtij fallsiteti është kur e di, je i sigurt që është falso, je prapë i detyruar ta besosh për të vërtetë, ndryshe do ikësh nga mentë, por kjo na ka shndërruar herë në papagaj, apo majmunë, herë në kanarinë pushverdhë që këndojmë nga sikleti për të kënaqur ata që na mbajnë mbyllur përmes varfërisë çnjerëzore…

Detyra e letërsisë është jo të ngjallim dashuri për Atdhe (kjo i takonte kohës se rilindjes), se çdo shqiptar e merr nga gjiri i mëmës, por t'u çelë sytë për të kuptuar se bashkimi dhe përparimi s'ven nga gjaku që derdh, por nga drita që ke për të parë e dalluar realitetin, që barbarët të mos e përdorin gjakun tonë për qëllimet e tyre… Dhe autori vë kujën, por nuk jep zgjidhje, kur sa herë luftohet për liri dhe fitojmë një skllavëri tjetër, ndaj në poezinë "Pemët rëndojnë nga drynat" do shprehej:

"Pemët e rënduara nga drynat
Gjëmojnë si Gjergji i plagosur
Si t'i shërojmë këto plagë të hidhura
Kur për çdo ditë po hapen edhe të më thella...
.....
Heshtin edhe muret
Thua se kanë vdekur perënditë
Një zë më vjen nga lashtësia
Vjen dhe thotë se s'kanë vdekur perënditë
Por njerëzit me shpirtra të dyshimtë."

Mërgimi, kjo plagë masive e popullit tonë, rrëfehet mrekullisht në poezinë "Pemët rendohen nga drynat". Ikja për tu kthyer është zhvillim, por ne jemi detyruar të ikim për të mos u kthyer, kjo është fatkeqësi! S'jam me atë që shqiptarët s'vijnë se s'kanë mall, por s'vijnë se s'gjejnë shtrat, shtetet tanë ua kanë rrëzuar atë që para se të ikin, kthimi i tyre bëhet i padëshirueshëm, ligjet e vendosura janë mure betoni të pakapërcyeshme. Kur ikin, sikur kalojnë një lumë në korrik, ku uji është gati në shterim, po të kthehen, ky lumë vjen bashkë me shkrirjen e borës gjithë shkumë e s'kalohet dot…Kështu në poezinë “Pa lejlek ky qytet duket i vdekur”, do të shprehej:

Qenkan boshatisur mëhallët
As pemët s’kanë ku të ulen
Ky shkretim shpirti
Ku do gjej një vend për të pushuar
.....

Paskan ikur edhe shtegtarët e vjeshtës
Pa lejlek ky qytet duket i vdekur
Ngjan me varret e vjetra
Ku për askënd më nuk ka vend.”Po thuaj i gjithë cikli i parë i këtij vëllimi poetik, trajton këtë temë të trajtuar dhe të papërfunduar nga gjithë poetët gjersa fatet tona janë ende pa fat...

Po të hedhësh një vështrim të përgjithshëm poezive lirike të dashurisë, vërehet një këndvështrim i cekët i kësaj ndjenjë hyjnore me fuqi të jashtëzakonshme shpirtërore.
Është normale që poeti / ja, do i këndojnë bukurisë, por bukurinë dashuri s'janë as sytë e zinj, apo larushë, as gjoksi pa dhe me silikon, as trupi, asnjë tipari veçantë i njeriut që dashurojmë, poezia i këndon imazhit që përforcohet nga shkrirja e të gjitha tipareve e krijimi i portretit të personit që kemi rënë në dashur, një portret pa tipare, një portret prej drite.
Dashuria kuptohet pas katastrofës që lë pas takimi i parë, katastrofë si të ishte një stuhi ku shkul drurët me rrënjë e çfarë gjen përpara dhe i duhet kohë shpirtit për të rindërtuar veten në një formë krejt tjetër e vetë dashuria të pajis me fuqi të jashtëzakonshme shpirtërore, të shton kreativitetin për rindërtimin e vetvetes krejtësisht në një formë tjetër që lidhet pazgjidhshëm me kohën dhe hapësirën, se sa e si favorizojnë apo pengojnë ato këtë rindërtim.
Të shkruash poezi për dashurinë, si forca më e madhe që godet një shpirt njerëzor për ta ndryshuar atë deri në shkallën sipërore drejt divinitetit, kërkohet nga poetët të zotërojnë kulturë dhe dije të gjerë në fushën e letërsisë, filozofisë, psikologjisë, teologjisë... Nuk mund të shkruajë poezi për dashurinë një poet që leximin s'e ka ushqim të përditshëm, apo një poet që s'e ka

provuar këtë ndjenjë me forcën e stuhisë... poeti edhe veshjen duhet ta ketë të veçantë, edhe vështrimin, edhe ecjen, qëndrimin... në çdo gjë, ai të jetë poezi...

Vetë sistemi komunist, në të cilin kaluam, i la "CURRA" (të vegjël), pa bagazhin e mjaftueshëm për të kuptuar të padukshëm, si pasojë e veprimit të dukshmesh nga e padukshmja. Ndaj e them me bindje të madhe, se pa këtë kapacitet të lartë intelektual, i cili fitohet jashtë mureve të shkollës, në vetë thithjen e dijes dhe kulturës kombëtare dhe botërore. Si mund të them, se janë poezi të arrira për dashuri në të cilët e nisin me fjalët "Të dua" dhe gjer në fund të poezisë ndahen, apo zhgënjehen...

Më vjen të mbyll facebook kur lexoj ndonjë poezi të tillë, ku merr mbi 200 “like”. Kështu nuk bëjmë gjë tjetër degjenerojmë shoqërinë, se nuk po kuptojmë më se kur quhet dashuri, kur kurvëri, kur tradhti bashkëshortore, se edhe të shkosh në shtrat një herë, u quajka dashuri e të nesërmen me një tjetër prapë dashuri e të kthehesh më pas të flesh në shtrat me bashkëshortin / ten dhe të mos quhet tradhti.

Vërtet letërsia nuk ndryshon sistemet shoqërore, por ajo përgatit njeriun për këto ndryshime. Si do të përgatitet shoqëria jonë shqiptare, kur krijuesit shkruajnë mrekullisht poetikisht bukur duke përcjelle mesazhe krejtësisht kundër një morali të shëndoshë të shoqërisë për një familje të qëndrueshme, si celula e parë e një shoqërie... Si të

jetë familja, do jetë shoqëria, çdo gjë e ka zanafillën aty, ty farkëtohet mendimi për të ndryshuar si për të mirë, apo për të keq.
U zgjata pak, i kërkoj ndjesë poetit, por e thashë edhe më lart, është kënaqësi të marrësh energji të reflektosh mbi bazën e një libri poetik.
Në procesin e rindërtimit të vetvetes, në këtë proces që quhet JETË, është pikërisht dashuria që shfaqet si mungesë e asaj çka kërkojmë, apo ta themi ndryshe, si një far që ndjell drejt perfeksionimit tonë. E them me bindje të pakontestueshme: njeriu që s'dashuron vërtetë, kurrë s'mund të perfeksionojë vetveten, se vetëm kur dashurojmë thellësisht, përpiqemi jashtëzakonisht të shkojmë drejt perfeksionit tonë për të qenë aq sa më të denjë për dashurinë...
Dashuria është në një farë mënyre, si të adhurosh Zotin e kur njeriu arrin me vetëdije të adhurojë Zotin, kërkon të bëjë gjërat më të mira, jo nga frika e Zotit, por nga dëshira për të mos e lënduar atë dhe në këtë përpjekje (e pa menduar) të komanduar nga misteri, s'kemi bërë gjë tjetër, kemi perfeksionuar veten me virtytet njerëzore duke u afruar sa më shumë shëmbëllimit të Zotit. Edhe dashuria, këtë bën tek njeriu, e perfeksionon atë drejt divinitet...
Figura letrare e apostrofit na sjell pranë atë që dashurojmë edhe përmes mijëra kilometrave largësi, ashtu siç kuvendonin mërgimtarët rilindas duke i afruar dhe shpirtëzuar malet, fushat, kodrat,

gërxhet, krojet... e vendlindjes së tyre, ndjenin praninë përmes ajrit, ashtu thërret dashuria dhe ia ndjen gjallësinë të dashurit/ ës përmes ajrit si frymë e shenjtë që të shndërron në dragua, të regjeneron shpirtin dhe trupi s'ndjen plakje...
Bukur e shpreh poeti në vargjet e poezisë "Tmerrësisht ndjej mungesën tënde" ku ndër të tjera shkruan:

“Eja kapma dorën të mos mbytem
Në gjolin e jetës
Të kam thënë dhe sërish po të them
Se ti je frymëmarrja ime
Si ta plotësoj këtë boshllëk pa ty
Secilin hap që e bëjë
Tmerrësisht ndjej mungesën tënde.”

Apo në poezinë "Nëse duam të zëmë trenin e dashurisë" ku shprehet:

“Ne e dashur prej fjalëve tona
Një ditë gjithsesi
Do ngrehim një kështjellë
S’do lëmë asnjë korb të fluturoj
Mbi çatinë e posa të ndërtuar

Nëpër secilin kënd të ngrehinës
Do vendosim
Nga një këndes të llamarintë
Le të na zgjoj herët në mëngjes
Sepse ata që flenë kurrë nuk zgjohen”

Dashuria troket te çdo njeri, të gjithë ajo i fton në start, por jo të gjithë futen në garë, po edhe shumë tjerë hyjnë dhe e lënë në mes të udhës, ata që prekin finishin, arrijmë të realizojnë veten dhe ata janë pak fare pak, por edhe një dritë mes errësirës mjafton për sydritët që të shkojnë drejt saj... Dashuria është SAKRIFICË, PËRKUSHTIM, në radhë të parë ndaj VETES, se cili përkushtohet vetes, i bën nder DASHURISË dhe anasjelltas... Kështu poezitë "Ajo është një lojë delikatë", apo "Ajo ka nevojë për frymëmarrje" shprehet qartësisht ky përkushtim i vazhdueshëm ndaj saj. Asgjë mos prit nga një njeri që nuk sakrifikon për veten, ai njeri jeton për të shtyre ditët, mungon dashuria e pse pretendon se lufton për të.
Dashuria është DHIMBJE, e vetmja dhimbje që të gjithë e dëshirojmë, por jo gjithkush e duron deri në palcë... Kështu në poezinë"Gruaja dhe stinët", në vargjet:

“Në një vazo të vjetër prej qelqi
Lule të freskëta plastike
Me një elegancë ta paparë ajo i ujiste
Dhembjet e stinëve...”

Po pse ne ende përpëlitemi si komb mes dashurisë së vërtetë dhe fallsitetit të saj???
Çdo shekull la njollat e errëta të pushtimit, por ardhja e Komunizmit e damkosi popullin tonë, e shpërfytyroi nga virtytet duke imponuar "cilësitë e

njeriut komunist" si një njeri që dashuronte dhunën dhe robërinë, si një njeri pa njerëzoren, ndaj poskomunizmi erdhi turbullirë, edhe në jetën e përditshme, edhe në letërsi e kudo... një turbullirë që e pse po kalon një çerek shekulli, një dorë e padukshme, por e prekshme shekujve, nuk e lë të kullohet... Poeti e shpreh bukur këtë në poezinë që dhe ka pagëzuar këtë libër poetik "Ne ishim të lumtur si gjinkalla", ne vargjet:

“Ishim të lumtur si gjinkallat
Nën pemët e shkulura
Tërë ditën këndonim në duet
Jo që i shkulëm nga skamja
Por ishte koha
Kur për një kumbull të papjekur
Të mbyllnin nëpër burgjet e mykura...”

Më duhet të qëndroj për ta mbyllur këtë recension, që ju të dashur lexues të hapni fletët e këtij vëllimi poetik për të mbledhur nektarin e poezive.

Zyba Hysen Hysa
(poete, shkrimtare, studiuese, publiciste)
Tiranë, më 6 Tetor 2016

Cikli i parë

Njeriu gjithmonë përsëritet

BRENDA MEJE ÇMENDEN MURET

Vjeshta e bezdisshme
Qenka ulur në prag
Mëngjesi shikon se si këputen gjethet
Bien si perënditë e çmendur
Në sofrën e gurtë të maleve

Një trishtil i braktisur
Trishtueshëm shikon nga majat
Zëri i drurit jehon në largësi
Era mjaullin nëpër skutat e lagjeve
Mjaullin si një mace e zgjebosur

Jashtë fryn era
Brenda meje çmenden muret
Çmenden ullukët e ndryshkur
Ky shi i mërzitshëm pandërprerë troket
Troket nëpër xhamat e palara të kujtesës

Në këto çaste veç bora mungon
Ky acar i gjakut i ngrinë lotët e pemëve
Asnjë njeri s’ troket në derë

Pragu në heshtje pret të nesërmen
Pret një tjetër pranverë

PO BIE SI TRISHTIMI

Në një trastë të grisur
I ruajta të gjitha stuhitë
Si një deve e lodhur
Eca ledheve të shirave

Lart në majat e kujtesës
Kullosin dhembjet
Shtatë herë mbrëmë gjëmoi Drini
Dhe po aq herë nga varri dolën
Eshtrat e një kohe

Asnjë njeri nëpër rrugë
Vetëm qentë endacakë bredhin
Si lejlekët nëpër sterrë
Bredhin nëpër motet e liga

Kurse dimri qenka futur në zgërbonjë
Dhe shikon se si këputen
Një nga një
Telat e fundi të kitarës

E shiu idhnak
Akoma nuk qenka ndalur
Po bie si trishtimi
Mbi kapelën time të grisur

ME DORËN E DJATHTË TA PREKI DIELLIN

Kur të vij çasti i ikjes
Më vendosni në maje të një plepi
Ose diku te retë
Atje lart
Përtej mjegullave nga zbritën të parët e mi

Dua që vetëtimave t'u bëj shoqëri
Me zjarret e mallit
T'i ndezi të gjitha dritat e dynjasë
Të mos ketë më
Asnjëherë errësirë në botë

T'u ndihmoj shirave
Sepse u duhet sa më parë ta gjejnë
Rrugën e qumështit
Për t'i ujitur fushat e gjëra të mëllenjave
Që si selvitë të rriten grunajat

Me dorën e djathtë ta preki diellin
Kurse me të majtën
Ta mjeli hënën
Dhe me dashurinë e qiellit
T'i ushqej fëmijët bonjakë

SONTE PO I NGJAJNË HARRESËS

Sytë e tua si dy gaca
Çuditërisht
Sonte po i ngjajnë harresës
Ku ishe atë çast
Kur të kërkova mes yjeve

I shkunda të gjitha pemët e dynjasë
I përtypa si kau plak
Kullosat e egra të stepave
Vetëm bari i venitur mbeti mes dhëmbëve
Mbeti si degët e thyera të ullirit

Kot i zgjata duart deri te retë
Nuk pashë asnjë grua mes mjegullave
Vetëm Zoti i erërave
Në rrugën time të pazbuluar
Qëndronte si gjithmonë vertikalisht

Prishtinë, 16 shtator 2016

BRENDA MUREVE TË MYKURA

Një kohë e shthurur
Mbi çatitë e rënduara nga dëbora
Dëgjoj krakëllima sorrash
Acari troket në portat e mbyllura
Çmendurisht troket mbi pemët e ngrira

Hijet e zeza veç kanë dalë rrugicave
Bredhin si djajtë e Ferrit
Atdheu lëngon në shtratin e vdekjes
Një dimër i mermertë
Shpërdridhet brigjeve të Drinit të Bardhë

Mbi kalanë e qytetit një vijë e hollë
Laracon hartën e grisur
Brenda mureve të mykura
Nga një sëmundje e rend vuajnë tjegullat
Vija e hollë dhe heshtja i kanë ndezur qirinjtë

Heshtin edhe muret
Thua se kanë vdekur perënditë
Një zë më vjen nga lashtësia
Vjen dhe thotë se s'kanë vdekur perënditë
Por njerëzit me shpirtra të dyshimtë

KURSE E NESËRMJA ASKUND NË HORIZONT

Gjithmonë imazhet e njëjta
Mes pemëve
Një mur i rrënuar
Dhe disa fotografi surrealiste
Zgërdheshen nëpër skutat e braktisura

Lehja e një qeni s'paska të ndalur
Më duket se po i imiton
Imazhet e lashtësisë së Itakës
Lehin edhe kalimtarët
Kur parakalojnë pranë varreve

Një kohë e shthurur deri në asht
Bisedon me kryqin e drurët
Kavakët me flamuj në gjysmë shtize
Vajtojnë të djeshmen
Kurse e nesërmja askund në horizont

SËRISH TË LEHURAT E PANDALSHME

E gjithë kjo zhurmë s'do me thënë asgjë
Hijet e pemëve
Më nuk po u ngjajnë hijeve
Veç atyre që fshihen si lukunitë
Mes gurëve të varreve

Kjo natë e gjatë s'paska të sosur
Në heshtje i numëron lëkurat e regjura
I numëron pemët një nga një
Diku në fund të qytetit
Dëgjohen zërat e gjyshërve

Sërish të lehurat e pandalshme
Sonte plepat s'paskan gjumë
Nëpër faltoret e posa të ngritura
U prenë me qindra këndesa
Vallë si do të zgjohet nesër mëngjesi

NJERIU GJITHMONË PËRSËRITET

Duke ecur
I përsërisim hapat e harruara
Nëse ndalemi
Ndryshken kujtimet
Harrojmë se sa hapa i bëmë deri më sot

Njeriu gjithmonë përsëritet
Përsëritet si stërkalat e shiut imcak
I ngjason lumit të çmendur
Pa asnjë derdhje
I cili kurrë nuk ka të shterur

Ecëm dje
Po ashtu edhe sot i dëgjuam hapat e erës
Do ecim nesër dhe një tjetër nesër
Përtej pafundësisë
Përtej të nesërmes së pa lindur

Ju thashë s'do të ndalemi asnjëherë
Do i numërojmë çastet
Dhe hapat e drurëve të lodhur
Si kavakët do i numërojnë gjethet
Por ne gjithsesi do ecim përtej vetvetes

Duke ecur shtigjeve të pashkelur
Do e përsërisim vetveten
Mes trajtave të hapave
Do i gjejmë udhët për ku jemi nisur
Do i tejkalojnë të gjitha mundësitë e rrugëve

SHOH MASKAT E TË GJITHA LLOJEVE

Më duket se stina kaloi
Në një gjendje tjetër
Të pashpresë
Një pemë e egër pa shpirt dhe formë
Qëndron përballë stuhisë

Retë e shkapërderdhura
Bredhin fushave si drerët e egër
Nga sytë e lëbyrta të ditës
Pikojnë trishtimet e shirave
Një kohë e shpërdredhur zvarritet rrugëve

Nëpër pijetoret e qytetit
Shoh maskat e të gjitha llojeve
Rrugët fantazmë ëndërrojnë prenë
Nën qepenat e dyqaneve
Palosen ngordhësirat e tërë qytetit

Hijet duken si mullar sane
Parakalojnë nëpër mendjen tonë
Si cofëtinat e një kohe
Me hapa të dehur rrugëve ecin lukunitë
Askund hije për zogjtë e plagosur

NËPËR FUSHA LULËZUAN BOZHURET

Nga dritarja e hapur si gjithmonë
Hynë ose dalin zogjtë e fëmijërisë
Një dorë e madhe
I hap edhe dyert e mbyllura kaherë

Kambana me kumbimin e saj
Përjeton ringjalljen
Lulet që i mbollëm para pak kohe
Çelën pa zbardhur agullima

Mes ullinjve të egër
Mbollëm edhe disa lloje pemësh
Sytë për herë të parë në trevën tonë
Çelën një lloj drite inkandeshente

Më duket se ishte ora e lindjes së diellit
Nëpër fusha lulëzuan bozhuret
Dhe të gjitha llojet e luledielli t
Mes shterpësisë së shkëmbinjve
Lulëzuan drurët

KUSH I PREU DRURËT HALOR

Posa i lëshoi putrat muzgu
Nga nëntoka shpërthyen orët e mira
Për ta pritur mëngjesin
Nga trarët e shtëpive dolën këndesat

Një kumri i përhitur
Si një qilimi dëneste nën një çati
Era me një kamxhik të tërbuar
I fshikullonte ullukët e mykur

Askund asnjë njeri në këtë qytet
Kush i preu drurët halor
Vetëm qepenat e thyer të dyqaneve
Herë pas here rrapëllojnë si në ëndërr

Sërish dëgjoj si gjithmonë
Zërin e pa artikuluar të ndërgjegjes
Shiu i mbrëmshëm ishte trishtim
Nuk i lau rrugët e baltosura të pikëllimit

DIKU NË VAUN E KUJTESËS

Nga dritaret e mbuluara me gazeta
Të shqyera dhe gjysmë të hapura
Shikojmë rrugën e dërmuar
Kalojnë njerëz të lodhur
Me nga një valixhe në dorë
Gra të përdala me flokë të shprishura

Nëpër rrugica të ngushta enden
Endacakët e të gjitha llojeve
Kumarxhinj me zare të dehur
Një shishe e zbrazët në xhepat e erës
Kënaqet deri në ekzaltim
Me të dehurit e lagjes së evgjitëve

Hëna e mërrolur mbase e ka mbyllur
Njërin sy
Dhe shikon në heshtje
Derdhjen e Lumëbardhit
Diku në vaun e kujtesës
Na zgërdheshet fëmijëria e uritur

E MARRIM DYNJANË NË SY

Kur i shkelim të gjitha rrugët
E qytetit
Ulemi në pijetoren e parë
Dhe rrufisim kafenë e ftohtë
Pas shpine zgërdheshet kamerierja

Pastaj kërkojmë një bujtinë të lirë
Ku na zgjojnë këndesat e egër
Ndoshta çmimi nuk bënë pjesë
Në pickimin e pleshtave
Por netët këtu janë të gjata si dhembjet

Kur zgjohemi nëse na del gjumi
Trokasim në pijetoren e parë
Sërish rrufisim kafen e akullt
Dhe me udhën nën këmbët e mykura
E marrim dynjanë në sy

PEMËT RËNDOHEN NGA DRYNAT

Shtëpitë me nga shatë dryna
Të boshatisura
Si kungujt e kalbur notojnë
Mbi trishtimin e ditës

Asnjë dritare nuk hapet
As nga brenda e as nga jashtë
Nën secilën çati
Duket se janë mbyllur kujtimet

Për çudi s'dëgjohen
As lehjet monotone të qenve
Një heshtje mortore
Rrëshqet mbi lagështit e mykura të mureve

Jashtë në rrugë dëgjohet zëri i akullt
I mëngjesit
Dëgjohet kakofonia e korit të bretkosave
Askush tjetër nuk bredh rrugëve

Pemët e rënduara nga drynat
Gjëmojnë si Gjergji i plagosur
Si t'i shërojmë këto plagë të hidhura
Kur për çdo ditë po hapen edhe më të thella

PASI QË TË VEGJLIT U RRITËN

Ne mbetëm të vegjël
Të rriturit u larguan
Ikën përtej deteve
Kush do t'i ujis lulet sivjet

Ka kohë që shirat
Nuk vijnë këndej pari
Nën rrapëllimat e ollukëve
Zambakët po fishken për çdo ditë

Vetëm kambana
Me zërin e saj nostalgjik
Kohë pas kohe lajmëron
Ardhjen e të reshurave që s'vijnë kurrë

Ja pra përse kemi mbetur të vegjël
Çerdhet po braktisen nga zogjtë
Pasi që të vegjlit u rritën
Dyert dhe dritaret u mbyllen

Prishtinë, 17 shtator 2016

PA LEJLEK KY QYTET DUKET I VDEKUR

Qenkan boshatisur mëhallët
As pemët s'kanë ku të ulen
Ky shkretim shpirti
Ku do gjej një vend për të pushuar

Më duket se qenka lodhur edhe kambana
Zëri saj i mekur
S'dëgjohet as dy hapa larg meje
Çfarë të bëjmë me kambanoren e shkretë

Dy njerëz si dy qirinj të lodhur
Bredhin shëtitoreve të zbrazëta
Askund asnjë pemë nuk rritet
Në këtë fushë të zhubrosur po qajnë zogjtë

Paskan ikur edhe shtegtarët e vjeshtës
Pa lejlek ky qytet duket i vdekur
Ngjan me varret e vjetra
Ku për askënd më nuk ka vend

KOLLITEN ME NJË ZË ASNJANËS

Nuk dihet më cila është kjo kohë
As natë e as ditë
Një mes kohë
Ku vetëm varkat e lodhura
Mund të notojnë deri në amshim

Një pemë e rrëzuar në hapësirë
I numëron gjethet e venitura
Ama as nuk janë të thara
E as të njoma
Duken si lëkura ime e zhubrosur

Kurse rrënjët lëvizin ngadalë
U ngjajnë dinozaurëve në ikje
Si njeriut u është rënduar frymëmarrja
Kolliten me një zë asnjanës
Mbase dimri veç paska trokitur kaq herët

JU THASHË JASHTË ASNJË NJERI

Dyert dhe dritaret
I kam lënë të hapura
Por askush nuk vjen sonte
As korbi s'troket në këtë kohë të lig

Qenkan shurdhuar edhe drurët
Nuk i dëgjojnë më as britmat e erës
Kurse rrapëllimat e dritareve
Nuk paskan të ndalur sonte

Shikoj në oborr
Asnjë siluetë njeriu s'duket te pemët
E dyert me një lëvizje monotone
Shëmtojnë bukurin e kësaj qetësie

Ju thashë jashtë asnjë njeri
Po ashtu edhe brenda
Vetëm këto pamje surrealiste
Po ma përkujtojnë fëmijërinë e kafshuar

TI NUK ISHE ASKUND MES GJETHEVE

Si i dehuri flinte nata
Kur i zgjova metaforat e kujtimeve
Asnjë njeri nëpër rrugë
Në parkun e vjetër dremiste stoli

Ti nuk ishe askund mes gjetheve
Disi më ike në heshtje nga ëndrra
Dhe kurrë më nuk të takova
As nëpër zhgjëndrrat e mia të përditshme

Kot i zgjata duart në drejtim të yjeve
Silueta e jote fshihej pas mjegullave
Ku t'i gjej fluturat e ikura
Kjo stinë sivjet për së tepërmi po vonohet

Sërish të kërkova mes fjalëve
Të kujtohet kur e lë peng tufën e flokëve
Atë ditë binte një shi i trullosur
Binte mbi mendimet e shprishura të ullukëve

S’PUSHONIN TINGUJT E NJË SERENATE

Na u kryqëzuan shikimet
Heshtëm
Asgjë nuk i thamë njëri-tjetrit
Më duket se atë çast ishim të huaj

Nata lëshohej mbi shpatullat e sterrës
Lëshohej me tërë peshën e saj
Përpos heshtjes
Asgjë tjetër nuk ngjau

Që të dy e vërejtëm qiriun
Dhe fluturën e cila e kishte humbur rrugën
Diku në fund të qytetit
S’pushonin tingujt e një serenate

Kur i ngritëm sytë kah yjet
Pamë se sa i errët ishte qielli
Nën shtatë palët e mjegullave
Hajdutët e kishin fshehur hënën

Ecëm edhe njëqind vjet pas shikimeve
Por kurrë më nuk i takuam
U shndërruam në dy statuja të mermerta
Sa anemike qenka kjo stinë e verbër

NGA NJË KRISMË PREJ FJALE

Ani që muret na ndanë
Ne sërish i prekëm yjet në hapësirë
S'patën se çfarë të na bëjnë malet
Sa për mure
E patëm fare lehtë t 'i rrënonim

Ishte kohë e egër
E cila shembte mbretëri fatesh
Por ne ju kundërvumë të gjithëve
Dashuria qe aq e madhe
Sa që ngadhënjeu mbi urrejtjen

Në secilin hap dëgjonim
Nga një krismë prej fjale
Por ne të përqafuar
Si era kalonim mes lisave
Kalonim përmes shikimeve sy prishur

DIKUR VONË KUR KËNDELLEN

Rrugëve parakalojnë njerëz
Të shtangur
Anemikë
Pa gjak nën lëkurë
Ecin si zogjtë e trembur prej stuhisë

Ecin e s'dinë të ndalen
Në asnjë stacion
I përcjellin trenat e çmendur
Kur dalin nga ëndrrat e dërmuara
Nëpër binarët e ndryshkur i zë gjumi

Kudo që u bie në sy ndonjë trampolinë
Ndalen si të shtangur
I përkundin të gjitha dëshirat
Dikur vonë kur këndellen
Kuptojnë se jeta qenka vetëm një ëndërr

LEXO SA TË DUASH BIOGRAFINË TËNDE

Me qindra herë kam pohuar
Dhe sërish pohoj
Se nuk ka vdekje
Mund të vdesin kujtimet
Fjalët e dhëna dhe parathëniet
Por njeriu vetëm e ndërron adresën

Njoh shumë të tillë
Njerëz me famë
Që kurrë nuk e pranuan vdekjen
Ata sot jetojnë si mbretër
Nëpër alet e qyteteve
Ose janë shndërruar në përmendore

Vdekja nuk është asgjë tjetër
Përveç se ndërrimi i adresës
Pa dashje del nga një dhomë
Dhe të vendosin ndoshta
Në dhomën tjetër
Me të gjitha komforet e saja

Të vendosin në një skutë
Pranë një tavoline me pamje surrealiste
Ngarkuar me libra të rinj
Dhe të vjetër
Në daç deri në amshim
Lexo sa të duash biografin tënde

Prishtinë, 18 shtator 2016

Cikli i dytë

Këta lisa e këta rrape

MË DUKET SE KISHE IKUR

Pothuajse tërë natën e lume
I numëruam yjet
Hëna endej qiellit si një vogëlushe
Endej si lozonjarja adoleshente

Meteorët bridhnin hapësirës blu
Asnjë zog tjetër të vetmuar
Nuk pamë në qiell
Përpos disa siluetave që u ngjanin njerëzve

Ti nuk ishe askund
Të kërkuam në rropullitë e galaktikës
Më duket se kishe ikur
Në një tjetër vend asnjanës

Kur u pamë mbase ishte vonë
Kishte kaluar stina e luleve
Ishin fishkur drurët
Kavakët u ngjanin hunjve të ngulur në tokë

BISEDOJMË ME ETËRIT PËR KOHËN

Nuk është lehtë të ecësh
Nëpër një vig
Ku thyhen dritat inkandeshente
Ne ecim përtej çdo mundësie
Në secilin hap mbjellim nga një shpresë

Ecim sepse s'guxuam të ndalemi
Në që se ngjan ndalja
Ne i humbim të gjitha shpresat
Mbesim si gurtë e shkretë të varreve
Pa asnjë shpresë

Sa herë që bie shi në qytetin tonë
I drejtojmë sytë kah qielli
I zgjasim edhe duart
Kontaktojmë me jashtëtokësorët
Dhe hijet në shpirtrat e mjegullave

Më pastaj ulemi pranë kujtesës
I bëjmë zë fëmijërisë
Dhe gjatë tërë kohës
Bisedojmë me etërit për vitet
Se si na lënë në këtë gjendje asnjanëse

PRESIN ZËRIN E ATDHEUT

Kundruall lisave të prerë
Një shtëpizë e vockël
Përbrenda saj plaku me parmendë
I hap plagët e tokës së etërve

Asgjë tjetër nuk dëgjohet
Përpos gjëmës së rrënjëve
Një hartë e vjetër sa koha
Del mbi tokë fundak e re

Disa ushta dhe një helmet
Qëndrojnë varur në gardhin e kujtesës
Ushtarët prej kohësh duken si heronj
Të gatshëm për betejat e reja

Presin zërin e atdheut
Dhe një njeri i cili do i ngjaj perëndisë
Nuk i besojnë më askujt
Përpos forcës dhe shpirtit të Hyjit

Pakëz më tutje në anën veriore
Muranat e një kishe të kahershme
Parmenda sërish i hap plagët e tokës
Dalin në shesh me mijëra ushtarë

SA HERË QË I SHFLETOJ LIBRAT E VJETËR

Mbi njëqind vjet trokas pandërprerë
Trokas nëpër portat e mbyllura
Të Evropës
Ky shurdhim njerëzish s'shpjegohet dot
Stuhitë e acarta
Po i rrahin muranat e shembura

Çfarë gabimi bëmë
Ku mëkatuam që kaq shtrenjtë
Po e paguajmë
Këtë heshtje tinëzare
Na u djegën ullinjtë nëpër fusha
Tok me drurët po kalben edhe rrënjët

Sa herë që i shfletoj librat e vjetër
Shoh se njëqind fytyra
Na paska historia
Deri në asht na e rropi lëkurën
Nëpër furrat e gëlqeres i dogjën hartat
Vetëm gjaku i etërve na mbeti testament

GJITHMONË ISHIM FAJTORË KUJDESTARË

Sa herë që u morëm me vetveten
Aq më shumë
Deri në palcë na kafshuan cerberët
Ndoshta në ashtin tonë
Me kohë është rrënjosur mallkimi

Kurrë askujt asgjë nuk i bëmë
Gjithmonë ishim fajtorë kujdestarë
Kush mbërriti
I gjuajti me gurtë e mallkimit sinorët
Na i mallkuan edhe varret

Kurse ne në vend se të merremi
Me të huajt dhe krimet e tyre
U morëm me vetveten
I akuzuam djemtë më të mirë të atdheut
Nga përmendoret i zbritëm heronjtë

Cili është ky mallkim
Që po na ndjek brez pas brezi
Akoma pa lindur fëmijët
Po vdesin në barkun e nënave
Cili Zot kaq trishtueshëm na mallkoi

MË DUKET SE EDHE VETË E PATËM FAJIN

O Zot largoje këtë mallkim
Nga kjo trevë e djegur
Dhe e zhuritur
Njëmijë vjet po i lusim perënditë
Dhe po aq vite
Po na rëndohen dhembjet

Kujt t'i lutemi
Dhe kujt t'i besojmë kur deri më sot
Askush nuk na i çeli
Portat e mbyllura
Përherë ishim në bisht të ngjarjeve
Historia ishte në anën e krimit

Më duket se edhe vetë e patëm fajin
I hapëm dyert barbarëve
Dhe na u bënë zot shtëpie
Kurse ne hyzmeqarët e tyre
Mbi njëmijë vjet
Po trokasim në portet e juaja

ISHTE DIKUR MOTI KJO MBRËMË

Mbrëmë u thyen të gjitha shtambat
Mbeti vetëm ajo
E pathyer e atdheut tim
Mbeti
Në duart e një vashe kosovare
Për ta shuar etjen e luftëtarëve të lirisë

Ishte dikur moti kjo mbrëmë
Që mbeti peng
Në dhëmbët e përgjakura të shekujve
Mbeti si një trishtim
Për të na shkulur identitetin
Por ne gjithsesi mbijetuam

Mbrëmë u thyen shtambat e thyera
E një kohe të largët
Mbete vetëm ti me një shtambë
Në fushën e mëllenjave
Po lind një diell i ri
I cili sa shumë po i ngjan lirisë

PRINA SA NUK ËSHTË VONË

Imzot ne jemi gati
Me rrufetë e zjarrta të atdheut
I kemi mbathur kuajt e luftës
Zgjohu o burrë
Prina
Me zërin tënd prej bubullime

Kaluan më se pesëqind vjet
Ne ende jemi në gjumë
Imzot
Po ndryshken ushtat dhe shpatat
Po na vithisen varret dhe mendjet
Zgjohu Imzot

Aiii të mjerët ne
Me këtë gjumë të përdalë
Zgjohu Imzot të thërret palla
Prina sa nuk është vonë
Mos lejo të na lindin fëmijët
Pa kryq e mëzdrak

Imzot malet janë quar peshë
Kruja krenare i përcjellë anijet
Që vijnë nga të katër anët e dynjasë
Nga sisa e djathtë e Rozafës
Imzot
Nga shpirti i pathyeshëm i urës
Çurgon qumështi i bekuar i një legjende

PËRKUNDI DHE RRITI NGA NJË PLIS

Eh moj fushë e mirë e mëllenjave
Me lulëkuqe prej gjaku
Që në këtë tokë je ngulitur
Si një pykë
Sa herë që erdhën të huajt
Ti për mrekulli dite
Dhe u mbete në grykë

Asnjëherë nuk respektove
Mbret as Perëndi
I deshe aq shumë pllajat
E tua të paskajshme
Sa që gjithmonë ishe e gatshme
Që për çdo pëllëmbë të kësaj toke
Të flijohesh e të bëhesh hi

Eh moj fushë e bozhureve
Kurrë nuk t'u heq gazepi
Me shekuj kalërove mbi kuajt e luftës
Atdheu për ty ishte djepi
Që nga secili dru a lis
Për lirinë tënde
Përkundi dhe rriti nga një plis
PËRPOS QË PRITE ZJARRIN E LIRISË

Sa herë që qajnë kuajt
I zoti i shtëpisë i ngjan Drinit të bardhë
Te korijet veç po kalben plepat
Atdheu si një zog i braktisur
Rri ulur në pragun e dhembjes

Ne herë ishim njerëz e herë kuaj
Nga palca e atdheut
Si rrëshira shtrydhej dhembja
Më duket se nuk kishim kohë për asgjë
As për atdheun i cili trishtueshëm lëngonte

Çfarë nuk pamë mbi supet e dërmuar
Kuaj të ngordhur
Dhe djelmosha të vrarë në pusi
Flamujt e grisur valonin si trishtimi
Atdheu ishte një plagë që s'kishte shërim

I palosëm drurët dhe gurtë
Pranë oxhakut të dhunuar
Zjarri dukej si një copë akull pa shpirt
Nuk ndizej me asnjë zjarr tjetër
Përpos që prite zjarrin e lirisë

MË SHUMË SE ASNJËHERË DHEMBJE

Më kanë lënë të pesë shqisat
Ikën edhe kuajt
Që qanin natë e ditë mbi dhembjen time
Ishte hera e fundi që në një mars
I prita lejlekët nga shtegtimet

Ky dimër ose fillim vjeshte
Nuk i paska pjekur ende pemët
Ullinjtë sivjet çelën
Më shumë se asnjëherë dhembje
Nga prehri i degëve fluturuan kumritë

Shëtitoreve bredhin qentë endacakë
Nëpër kontejnerë gjëmon zbrazëtia
Aleja e përmendoreve në heshtje shpreson
Dorën e njeriut
Shpreson në një tjetër stinë të çeli si lulet

KËTA LISA E KËTA RRAPE

Këta lisa e këta rrape
Bashkë me drurët e këtyre maleve
Dikur ishin gjallë
Merrnin frymë si njerëzit
Nën degët e tyre të gjëra
Kuvendonin burrat për dertet e atdheut

Besa edhe gratë thurnin çorapë
Djemurisë që bëhej gati për luftë
Po ju them
Ishin të gjallë si njerëzit
Drutë e atdheut tim
U ngjanin zogjve të shenjtë

Sa herë që na u deshtë
Të na ngrohen eshtrat
Na dhanë nga një barrë dru
Këta rrape e këta lisa të atdheut
Na mbajtën gjallë
Sa e sa djepa nxorëm nga shpirti i tyre

Në kohërat më të liga
I përkundëm djepat dhe plisat
Rrapet i hapnin krahët na përqafonin
Nga shpirtrat krenarë të këtyre drurëve
Me xhelozi i rruajmë reliktet e ninullave

UNË KURRË NUK I BESOVA QESHJES

Më thanë se për një zonjë
Poezia është natë
E cila vetëm kur paraqitet
Eklipsi i diellit lexon recitalin malësorit

Më pastaj vrapon pas ninullave
Ani që kurrë nuk e ka përkundur djepin
Ajo ëndërron hënën
Duke rrëshqitur nëpër malet e qiellit

Më kujtohet kur qante kaprolli
Nën thundrat e një trekëndëshi
Vepronin me qindra probleme
Të pazgjidhura matematikore

Ajo sërish i tundte shpatullat
Nga gjoksi i saj i brishtë pikonte dita
Unë kurrë nuk i besova qeshjes
Sepse gjithmonë pata kokëçarje me etjen

SHIKOJMË PËRRETH NESH BRYMËN

Ngjan që sa herë kur nuk kemi
Se çfarë të themi
Ne ngjitemi te yjet
Ndoshta nga asgjëja kërkojmë derman

Por gjithsesi kur takohemi
Me meteorët e akullt
Gishtat tona disi bëhen sikur
Ndjejnë ngrohtësinë e yjeve

Kjo ndjenjë duket e përçudnuar
Thua se nga prekjet tona
Lindin meteorët endacakë
Kurse ne shikojmë kah ngjizen xixëllonjat

Posa të zbresim nga udhëtimi imagjinar
Na ulen edhe gjakrat
Shikojmë përreth nesh brymën
E cila në çdo kohë e ndërron ngjyrën

KURSE ME TJETRËN

Mbrëmë e pashë hënën
Se si lëvizte ngadalë
Lëvizte ndër degët e ullinjve
Lëvizte si merimanga
Kur e thurë rrjetin e fjalëve

Hëna dhe nusja e lalës
Një duet i përkryer
Në përsosmërinë e natyrës
Njëra e ngadalshme
Kurse tjetra i ngjan furisë

Por gjithsesi
Që të dyja sa shumë ngjanin
Me njëra - tjetrën
Sa që nga flokët e thinjura
I këputa dy fije të mëndafshta

Me njërën i lidha në nyje
Të gjitha kujtimet e mia
Të adoleshencës
Kurse me tjetrën
Enda pëlhurën e këmishës së imagjinatës

PËRRETH FËMIJËT LOZIN PA BRENGA

Sapo zbres te Ura e Gurit
Takohem me qeshjet e myshqeve
Një nostalgji e lashtë si një hije
Pështillet rreth kapelës sime

Vetëm gurgullima dhe guralecët
E kuptojnë lojën e valëve
Dëgjojnë edhe zërin e shurdhër
Të peshqve memecë

Aty pari disa kalimtarë të panjohur
Pasi që pinë ujin e Shatërvanit
Gjuajnë ndonjë qindarkë
Në koritën e gurtë të fatit

Përreth fëmijët lozin pa brenga
Nuk e qajnë kokën për të dashuruarit
Le të gjuajnë sa të donë qindarka
Zogjtë gjithmonë ulen në çerdhen e vet

PASKAN NJË PAMJE TË VERBËR

Sonte mbase për herë të parë
Mbi flokët e thinjura të erës
Po bie një shi i trentë
Dhoma ime e vogël rritet tej mase

Më ngushtohet hapësira e tejdukshme
Rritet edhe shtrati im i drunjtë
Dritaret e gozhduara
Herë hapen e herë mbyllen në heshtje

Dera e hyrjes së apartamentit
Në këtë kohë
Nuk hapet për askënd
Mbase është mbyllur nga brenda

Dritaret e errësuara
Paskan një pamje të verbër
Si nëpër mjegull
Hajnisht i shikojnë kalimtarët

Sonte sërish nuk pushon
Ky shi i mërzitshëm
Troket nëpër xhama si korbi i Edgarit
Troket në kokën time të lodhur

Prishtinë,19 shtator 2016

AS ME MUNGESËN E NËNËS

Më kujtohet kur iku nëna
Iku çdo gjë që më lidhte me dashurinë
Ajo grua e madhe
Sa e vockël u duk atë ditë në qivur

Aq e vogël sa që nuk më lënë
Ta përqafoj për herë të fundit
Nuk ishte një ikje e zakonshme
Ikja e saj ngjante me amshimin

Kam përjetuar në jetë disa lloje ikjesh
Por kjo ikje e papritur
Me asgjë s'mund të krahasohet
As me mungesën e nënës

Ja pra iku edhe ajo
Ikja e cila i ngjante frymëmarrjes
Lehtas doli nga dera e shtëpisë
Dhe kurrë më nuk u kthye

PËR KËTË QYTET FANTAZMË

Ora e diellit qenka ndalur në qytet
As në stacionin e vjetër
S'punon ora e murit
Binarët nuk ecin paralel
Trenat në qytetin e të vdekurve
Rrëshqasin vetëm në një drejtim

Pranë muranave të kishës së rrënuar
Shpeshherë shoh njerëz me shpinë të kthyer
Ose disa sosh të shthurur
Që u dëgjohen britmat e pakontrolluara
Dhe me gjeste banale
Drejtohen kalimtarëve të rastit

Për këtë qytet fantazmë
S'kanë më se çfarë të shkruajnë kronistët
Nëpër shtëpitë njëkatëshe
Oxhaqet nuk tymojnë në drejtim të qiellit
Varfëria e pllakosur e mjerimit
Varet si drynat nëpër dyer të mbyllura

Dhe sërish e sërish
Orët janë ndalur njëherë e përgjithmonë
Nuk kalojnë as trenat me vagon kafshësh
Mbi traversat e kalbura çiftëzohen macet
Para se me marr krah zogjtë
Si të ngordhur plandosen në tokë

PRANË PORTRETIT TË PAGJUMËSISË

Mbi tavolinën monotone
Enët dhe pjatat e palara
Lëpihen si nuset

Një mizë e bezdisshme
Në gjeografinë e dhomës
Kërkon zëzëllimën e humbur

Pranë portretit të pagjumësisë
Paska zënë vend
Sterra e dendur e kësaj nate

Karriget vallëzojnë në heshtje
Vallëzojnë edhe gjethet e vjeshtës
Në oborr mjaullinë një mace e sëmurë

Mjaullin edhe era
Shirat veç kanë filluar lojën e stërkalave
Vallëzojnë me fluturat e posa të lindura

PO ASHTU EDHE HISTORIA SHTRIGË

Në një shportë të madhe
Pa asnjë formë gjeometrike
Qenkan grumbulluar të gjitha rraqet
Me dhe pa kurrfarë vlere

Këpucë të grisura dhe pantallona
Me qindra arna i paskan mbyllur
Të bëmat e tyre
Në një tregim me nëntë dryna

Një mi i thinjur po e grimcon të kaluarën
E gjërave të hedhura
Grimcon me dhëmbët thikë
Një libër kush e di se të cilës kohë

Këtu në qytetin tim fantazmë
Orë e çast kanë ndryshuar kohërat
Po ashtu edhe historia shtrigë
Mbase ka se çfarë të grimcojë ky mi i thinjur

SI NJË LLOJ RELIKTI TË PAÇMUAR

Sa herë që ulem në kanape
Vështroj hapësirën e paanë të horizontit
Vështroj në një tjetër mënyrë
Ikjen e lejlekëve nga atdheu

Fëmijët tani më të rritur
Ngjajnë me gjethet e vjeshtës
Dhe me hapat e tyre gjigantë
E marrin botën e vockël në sy

Marrin nga shpirti i kësaj toke
Afshin e dheut mëmë
Kur t'i zë malli i atdheut
I marrin erë në ndonjë skutë të dynjasë

Kudo që shkojnë e mbërrin
Bartin me vete një grusht dashuri
I bartin kujtimet e atdheut
Si një lloj relikti të paçmuar

UDHËTARËT E SË NESËRMES

Shiu i mbrëmshëm nuk i ngjante shiut
Ndoshta ishin lotët e atdheut
Të ngrohta si llavë vullkani
Mbyteshin në kraterin e shpirtit

Ah ai shi i mallkuar që binte pareshtur
I verboi të gjitha yjet
I verboi edhe rrugët e dhembjes
Andaj s'kemi se si të kthehemi

Një trishtil i frikësuar qante mbrëmë
Mbi një degë të thyer të udhës
Qanin edhe kanjushat e verdha
Largësinë e paarritshme të takimit

Ku mbetëm si gur varri udhëve të dynjasë
Pa farë e pa fis
Udhëtarët e së nesërmes
Që ëndërrojnë një kapelë e një plis

ATA TË PËRDATUR KËRKONIN VETËM NUMËR

Nuk di me sa vetë më pak
Mbeti atdheu atë ditë
U vranë shtatë
Ose shtatëqind njerëz
Por gjithsesi
Ishte një numër shumë i madh të vrarësh

I vranë në mënyrë më barbare
Ishte një vdekje me short
Përveç numrit
Mosha s'kishte rëndësi
Po ashtu edhe gjinia
Ata të përdatur kërkonin vetëm numër

Emrat përveçëm ishin vendosur
Në një helmet të metaltë
Me gishtat skelet një karikaturë
Çelte fall me jetën e një populli
Si nga një humnerë nxori listën e shënuar
Krismat dhe britmat s'kishin të ndalur

AQ MË SHUMË ARMË PËR TË SOTMEN

Sa pak zogj nëpër qiell
E sa pak qiell për zogj
Nuk kanë as vend ku të ulen
I prenë ullinjtë
I rrafshuan me tokën

Cungjet më s'kanë jetë
U ngjajnë të vdekurve
Nëpër varret e vithisura
Nuk marrin frymë
Duken si gurtë e djegur në diell

Sa pak njerëz në këtë lëndinë
Sa pak varre për fluturat
Ata që i dogjën pemët
I plagosën edhe ninullat
Djepat e zbrazët vajtojnë si kërthi

Sa pak flutura të larme
E sa shumë njerëz me sëmundjet
E të gjitha llojeve
Sa më pak shpresë për të nesërmen
Aq më shumë armë për të sotmen

SHKOFSHI NË DREQ TË MALLKUAR

Nuk bëra asnjë hap deri te ju
Kurse ju me bisht ndër këmbë
Ikët si djalli prej temjanit
Mbase as nuk kisha
Se pse t'i kapërcej këto male
Ju vetë erdhët në tokën tonë

Erdhët dhe e mbuluat fushën e mëllenjave
Me ferra të zeza
Ju ishit djalli i djajve të egër
Në vend se të mbillni një pemë paqeje
Ju i mbollët me urrejtje trojet tona
Mbollët vdekjen e zezë

Largohu ik nga erdhe o Lucifer
Mos paçi vend as atje
Sepse fara e keqe
Nuk mund të mbijë askund
Kudo që shkeli këmba e juaj
U bë shkretim
U shkretofshi për jetë e mot

Nuk i ka hije njeriut të mirë
Ky fjalor as ky mallkim
Por fajtorë kryesor jeni ju
O bijtë e bijve të lugetërve
Shkofshi në dreq të mallkuar
E mos u kthefshi kurrë më në tokën tonë

Cikli i tretë

Ishim të lumtur si gjinkallat

TMERRËSISHT NDJEJ MUNGESËN TËNDE

Eja e dashur
Eja të lutem t'i lidhim
Në një nyje të vetme
Të gjitha problemet e vogla
Dhe ato të mëdha
Të mos zgjohen askurrë më ankthet
Në rrugëtimin tonë të gjatë

Të ecim ballëhapur dhe vertikalisht
Në jetë siç ecëm deri më sot
T'i lëmë anash thashethemet
Sepse jeta e askujt
Nuk përbëhet prej problemeve
Por ka diçka tjetër
Më madhështore që quhet dashuri

Eja kapma dorën të mos mbytem
Në gjolin e jetës
Të kam thënë dhe sërish po të them
Se ti je frymëmarrja ime
Si ta plotësoj këtë boshllëk pa ty
Secilin hap që e bëj
Tmerrësisht ndjej mungesën tënde

SËRISH TROKITA TE RETË

Jashtë fryn era
Brenda bie shi
Kjo muzikë e trishtë
Disi bënë kërdi

Ku ishe mbrëmë
Kur qante era
Asnjë zog s'trokiti në dritare
Në korie dëneste pranvera

I hapa të gjitha portat
Askund s'pashë njeri
Vetëm era lozonjare
Lozte në bahçe si një fëmijë

Sërish trokita te retë
Shirat veç kishin fjetur
Një etje e madhe
Thërriste ëndrrën time të tretur

NËSE DUAM TA ZËMË TRENIN E DASHURISË

Ne e dashur prej fjalëve tona
Një ditë gjithsesi
Do ngrehim një kështjellë
S'do lëmë asnjë korb të fluturoj
Mbi çatinë e posa të ndërtuar

Nëpër secilin kënd të ngrehinës
Do vendosim
Nga një këndes të llamarintë
Le të na zgjoj herët në mëngjes
Sepse ata që flenë kurrë nuk zgjohen

Kështu që
S'guxojmë të përgjumemi aq shumë
Gjumashët nuk i do askush
Ne duhet të mos flemë asnjëherë
Nëse duam ta zëmë trenin e dashurisë

SA QË TË NGUFAT ATY PËR ATY

Më fal të lutem
Ne dhe të gjithë duhet të kuptojnë
Se dashuria është një lojë delikate
E cila kurrë nuk përfundon

Do i hapim të gjitha portat
S'do lëmë të mbyllur asnjë dritare
Ajo ka nevojë për frymëmarrje
Nëse ia zëmë frymën dashuria vdes

Botërisht dihet se i vdekuri
Veç është në një rrugë të gjatë
E dashuria s'guxon të shndërrohet në zog
Ajo duhet të konvertohet në çerdhe

Më fal të lutem nëse nuk e kupton lojën
Kurrë mos hyrë në valle
Sepse ajo i ka të trishtuara ingranazhet
Sa që për së gjalli të ngufat

PO DËNES CELULARI NË HESHTJE

Mbrëmje e qetë pa asnjë zë
Hëna lozonjare
Me lotin e thyer të muzgut
I lanë gjinjtë e saj prej mermeri

Aty këtu nëpër oborr dëgjohen
Zërat e pa artikuluar të gjinkallave
Në portat e hapura
Nuk mejnë të trokiturat e shurdhëta

Një hije herë ecën drejt
E herë thyhet
Nga parmakët e dritareve
Tërë trishtim shkunden pemët

Ajo nuk erdhi sonte
Mbi kanapenë e vjetër
Me lot ngashërimi
Po dënes celulari në heshtje

DISA POHONIN SE ËSHTË DIMËR

Është natë hëna qëndron pezull
Si një mollë e kalbur në degë
Ajo në dorë mbante një mjet
Ose një gjë të papërcaktuar

Ndoshta është një lule
Ose një imitim luleje prej plastike
Por gjithsesi
Dukej si një origjinal i falsifikuar

Merrte erë me shqisat e lodhura
Në dorën e majtë
Mbante një qiri të ndezur
E në të djathtën një copë akulli

Disa pohonin se është dimër
Kurse disa të tjerë
Jetonin me kënaqësitë e pranverës
Kurse mbrëmja asnjanëse qante si kalama

GRUAJA DHE STINA

Në një vazo prej qelqi
Lulet e freskëta plastike
Me një elegancë të paparë i ujiste
Dhembjet e stinëve

Një bretkosë me një brushë në dorë
vizaton varfëritë e imazheve
Jashtë te pemët e plakura
Shkundeshin frytet e thara

Stina dhe gruaja e vetmuar
Shikojnë njëra - tjetrën
Njëra ja numëron rrudhat e ballit
Kurse tjetra thinjat e flokëve

Një numërim alegorik
Zbret ngadalë prej shkallëve
Gruaja me një tufë lulesh plastike
Kurse stina me thinjat e flokëve në dorë

Prishtinë,20 shtator 2016

DITËN KUR U PAMË

Ne nuk ishim asnjëherë të vegjël
Ditën kur u pamë
Stinët veç na kishin shkelur
Deri në asht
Ty të ndiqnin cerberët e egër
Kurse mua langonjtë e përjargur

Nuk na lënë as të përshëndetemi
Aq shumë e deshëm një puthje
Sa që buzët tona
U shndërruan në mermer të kuq
Të thashë se kurrë s'qemë të vegjël
Na rriti dhuna e përditshme dhe skamja

Fare mirë më kujtohet
Kur nga flokët e tua të shkulura
Çurgonte gjaku si bozhuret e Kosovës
I kuq si turpi kur skuqeshin faqet e tua
Në puthjet tona të gjata
Që të dy ishim një copë zjarri në hapësirë

ISHIM TË LUMTUR SI GJINKALLAT

Më duket se asnjëherë nuk patëm dimër
Afërsia jonë
I ngrohte të gjitha skutat e skamjes
Sa herë që kishim të ftohtë
Dhe uri
Na ngrohnin
Dhe na ngopnin puthjet tona të zjarrta

Ishim të lumtur si gjinkallat
Nën pemët e shkulura
Tërë ditën këndonim në duet
Jo që i shkulëm nga skamja
Por ishte koha
Kur për një kumbull të papjekur
Të mbyllnin nëpër burgjet e mykura

Mbyllën çfarë deshën
Dhe kujt ja vunë syrin
Por për dashurinë tonë
Nuk pat askund burg as çeli
Ngjau e kundërta
Për të triumfuar dashuria e jonë
Ne i mbyllëm të gjitha burgjet

POR MË KUJTOHEN KOHËRAT E MIRA

Të kujtohet kur i thoshim njëri - tjetrit
Se ne kurrë dhe asnjëherë
Nuk do të plakemi
Kur i shoh sot këto rrudha të urtësisë
Po bindem se kishim qenë në lajthitje

Nuk di se ku i kemi lënë
Letrat e shkruara
Dhe cili pëllumb na i sillte
Por më kujtohen kohërat e mira
Kur nën qiellin e zi i hapnim zarfet e kaltra

Asnjëherë nuk patëm dimër
Në jetën tonë
Gjithmonë ishte pranverë
Në buzëqeshjet e Lumëbardhit
Stinët e tjera ishin të huaja për ne

Sa herë që i mbolla zambakët
Në flokët e tua të gështenjta
Po aq herë çuditërisht
Çelnin disa lloje lulesh
Që nuk rriteshin në anët tona

LULET MË TË BUKURA

Nga një largësi e pamatur
Mund të jetë edhe nga lashtësia
Më thërret zëri i përmallimit të etërve
Më thërrasin ata që i desha
Dhe më duan
Më thërret nostalgjia

Vetëm zëri dhe thirrja e jote
Më mungojnë
Më mungon buzëqeshja e pranverës
Të kujtohet kur i shkundin ftonjtë
Vjeshta ishte e ngrohtë
Sa shumë i ngjante dashurisë sonë

U betuam me njëri – tjetrin
E lëmë peng dashurinë dhe fjalët
Sa që akoma sot po çelin lule
Po çelin në stinët e egra të jetës
Lulet më të bukura
Që çelnin dikur në rininë tonë

SI LIBRAT E VJETËR I SHFLETOJ KUJTIMET

Tani më është vonë
Si dhembja më zgjohen kujtimet
Asnjë flutur e kaltër
Mbrëmë nuk trokiti në dritaren time

Si çdo gjë që mungon në këto çaste
Më mungon edhe ti
E di që ishe në dhomë me fluturat
Por befasisht ike luadheve të blerta

Kjo qetësi relative më bënë të çmendem
Të kërkoj gjithkund
Ti s'lajmërohesh as nuk më vjen
Çfarë të bëj me këtë vetmi e cila më ngufat

Si librat e vjetër i shfletoj kujtimet
Në një kënd i gjej këpucët e tua
Në tjetrën çantën e blerë në Stamboll
Kurse siluetën tënde se shoh as në pasqyrë

Të kota ishin thirrjet e mia
Tani më secili zë më duket i huaj
Vetëm kitara e vjetër në paradhomë
Po dënes si një qilimi i braktisur

PO NUK ERDHE TI ATO KURRË NUK DO TË HAPEN

Pasi që ti më mungon
Sonte do t'i shkyçi të gjitha mendimet
Do hy në mbretërinë e heshtjes
Dua të vetëngujohem
Deri në asgjësim

S'dua as të marr frymë
Do i shkyçi të pesë shqisat
Asgjë nuk më duhet në këtë vetmi
Sa shumë po më mungojnë
Duart e tua të brishta

Të lutem deri në gjunjëzim
Zgjohu nga mbretëria e ëndrrës
Nuk je copë guri
Por një grua prej ashti e mishi
Me të gjitha shqisat e tua delikate

Zgjohu që t'i zgjojmë nga e kaluara
Të gjitha kujtimet e shkyçura
Letrat e tua të palexuara ende janë
Në zarfet e kaltra të kujtesës
Po nuk erdhe ti ato kurrë nuk do hapen

NË CILËN ËNDËRR U FUNDOSE

Mjaft më sa shumë i durova
Këto britma të dhembjes
Ku je tani
Në cilën ëndërr u fundose
Zgjati duart e brishta të lutem
Më nxjerr nga kjo errësirë

Nuk di a mund të më kuptosh
Se sa dhemb shpirti
Asnjë plagë pushke s' krahasohet
Me plagën e dashurisë që kullon trishtim
Mos më lërë në këtë zëndan
Të ngufatem nga frymëmarrja e munguar

Mjaft më me lojërat e tua s'jetohet kështu
Unë nuk marr frymë dot si njeri
Po i përngjaj bretkosave nëpër moçale
Sytë më janë mbufatur nga lotët
E eshtrat po më tkurren nga dënesja
Po tkurret lëkura ime si dajrja e ciganes

KUR AFROHET KOHA E IKJES

Kur afrohet koha e ikjes
Nuk dua askënd pranë meje
Le t'i shkyçin të gjitha yjet
Unë sërish
Do e gjej rrugën deri te ti

S'dua asnjë pekule
Në udhëtimin tim të fundit
Më mjafton vetëm zëri yt
Që të orientohem
Në rrugëtimin e gjatë dhe të pa kthim

E di ti do të jesh ylli im orientues
Deri më sot
asnjëherë nuk e humba rrugën
S'do e humbi as nesër
Deri te dashuria ime domosdo do të mbërri

Kur afrohet koha e ikjes
Përveç teje
S'dua që askush të jetë pranë meje
Ti dhe duart e tua mund të me vendosin
Në qivurin e ëndrrave të pa ëndërruara

PATËM NJË TJETËR NDJENJË

Sa herë që pushuam në pragje shirash
Patëm një tjetër ndjenjë
Duart tona lëviznin si stërkalat
U ngjanim drurëve që çelnin dashuri

Ishim të lumtur si xixëllonjat
Sytë tanë ndriçonin mes yjeve
Si dy kandila të ndezura
Që kurrë nuk shkyçen nga asnjë dhembje

Më kujtohen çastet e adoleshencës
Të kujtohet edhe ty
Se si e kërkonim yllin tonë në hapësirë
Pastaj i numëronim yjet deri në mëngjes

Asnjëherë nuk harruam të kapemi
Dorë për dore
Ishte e vetmja mënyrë për ne
Që secili të ngjizet me yllin e vet

GJITHMONË DASHUROVA VETËM NJË STINË

Me të thënë të drejtën
Mua nuk më pëlqejnë stinët
Gjithmonë kam ëndërruar vetëm një stinë
Dhe ty e dashur
Mes luleve që nuk e njohin venitjen

Të lutem harroi stinët
Jeta ka vetëm një stinë të bardhë
Ato të tjera
Nuk janë asgjë tjetër
Përpos fëmijë asnjanës të kohës

Më kujtohen kohërat e kaluara
Dhe hapat e tua në një stinë
Të buta si retë
Kur shkelshin mbi kristalet e borës
Shkelshin bardhësinë si sutat e egra

Që nga ajo kohë
Fillova të mos i dua stinët
Gjithmonë dashurova vetëm një stinë
Që me tërë bardhësinë e saj magjepse
Të jetë e bardhë si shpirti i një gruaje

KUR I NGJYROSËM MËNGJESET

Më mbetën në duar të gjitha akuarelet
Kurse shirat ende nuk pushuan
Ku ishe ti kur nën qiellin lakuriq
Tringëllinin trishtimet e kristalta të acarit

Në agimin tim të përgjumur
I zgjova të gjitha baladat e fjetura
Kurse ty moj gjinkallë e lazdruar
Të zuri gjumi nën çatinë e kujtesës

Nuk di athua vallë të kujtohet
Por ti fjete një kohë të gjatë
Mbase ende je duke fjetur
Mes gjetheve të përgjumura

Mbi njëqind vjet pres të zgjohesh
Të t'i dhuroj po ato akuarele
Kur i ngjyrosëm mëngjeset tona
Me ngjyrat më të bukura të imagjinatës

NËSE TI MË MUNGON

Nëse ti mungon
Pranë dhembjes sime
Çfarë të bëjë me duart e mia
Kjo etje s'paska askund fund
Nuk më duhen në këto çaste
As yjet e qiellit blu

Mi afro duart e tua të rrudhosura
Kam nevojë të madhe
Që vetëm ato të më përqafojnë
Çfarë të bëj me yjet
Ata kurrë dhe asnjëherë
Nuk e patën ngrohtësinë tënde

Me gjithë këto shëmtira
Dhe turpe që të mbulojnë
Unë prapëseprapë të dua atdheu im
Të dua aq shumë
Sa që mund të të krahasoj
Me dashurin time të madhe

PUTHJET

Sa herë që u puthëm
Gjithmonë putheshim
Një herë më pak
Kurse ne aq shumë deshëm
Që puthjeve tona
Të mos iu vëmë asnjëherë kapak

Prishtinë, 21 shtator 2016

SHËNIME PËR AUTORIN

Adem Zaplluzha u lind më 1 shkurt 1943 në Prizren. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, ndërsa Akademinë Pedagogjike në Prishtinë. Disa kohë punoi si mësues nëpër fshatrat Studençan të Therandës (ish Suharekës) dhe Hoça e Qytetit, afër Prizrenit. Ndërkohë punësohet si përkthyes në Korporatën Energjetike të Kosovës. Me shkrime filloi të merret, kryesisht me poezi, që nga mosha e fëmijërisë. Rrugën letrare e nisi me vjershën e parë për fëmijë, të cilën e botoi në revistën "Pionieri" më 1957. Si i punësuar në Korporatën Energjetike të Kosovës, bashkë me shokët e punës dhe të pendës, themeloi grupin letrar "Lulëkuqet e Kosovës". Në kuadër të punës së këtij grupi letrar, qe botuar përmbledhja "Ngjyra e kohës", në të cilën u përfshi një numër i konsideruar i poezive të tij. Krahas krijimeve të publikuara në revistat për fëmijë, botoi edhe një serë shkrimesh nëpër gazetat e kohës, që dilnin në Prishtinë dhe Shkup. Është anëtar i Lidhjes së shkrimtarëve të Kosovës, prezent në disa antologji dhe në librin Kosova letrare të poeteshës Monica Muresha. Është prezantuar në Leksikonin e Shkrimtarëve Shqiptarë 1501-1990, nga Hasan Hasani, në Leksikonin Shkrimtarët Shqiptarë për fëmijë 1872 – 1995, nga Odhise K. Grillo, si dhe në librin Portrete Shkrimtarësh nga Demir Behluli, Prishtinë, 2002. Në maj të vitit 2013 Klubi i Artistëve dhe i shkrimtarëve të Durrësit ia ndau çmimin e karrierës për kontributin e dhënë në letrat shqipe.
Jeton dhe krijon në Prishtinë.

BOTIME TË AUTORIT

1.“Puthje”, poezi, “Rilindja”, Prishtinë,1974.
2. “Ecjet e viteve të mëdha”, poezi, “Jeta e Re”, Prishtinë 1995.
3. “Çamarrokët e Thepores”, poezi për fëmijë, “Shkëndija”, Prishtinë 1996.
4.“Muret”, poezi, “Jeta e Re”, Prishtinë, 1997
5. “Morfologjia e dhembjes”, poezi, “Faik Konica”, Prishtinë, 2000
6. “Ai vjen nesër”, poezi, Qendra e Kulturës, Klubi letrar “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2007
7. “Letër nga mërgimi”, poezi, Klubi letrar “Fahri Fazliu” Kastriot, 2007
8. “Letër nga mërgimi 2 “ poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar , “Fahri Fazliu”, Kastriot 2007
9. “Udhëndarja”, poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar ,“Fahri Fazliu”, Kastriot , 2008
1o“Thirrje e gjakut”, poezi,”Qendra e Kulturës”, Klubi letrar, “Fahri Fazliu”Kastriot 2008
11. “Asgjë sikur molla”, poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2009.
12. “Vesa në lotin tim”, poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar “Fahri Fazliu”, 2009,
13. “Puthja e gozhduar”, poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar, “Fahri Fazliu”, Kastriot , 2009.
14. “Kashelasha në vargje”, poezi për fëmijë,” Qendra e kulturës, Kastriot, 2009.
15. “Pema e bekuar”, E përkthyer, Rumani, 2010.

16. “Bajraktarët e vatanit”, poezi satirike, Klubi letrar, ”Fahri Fazliu” Kastriot , 2010.
17. “Hijet e ndryshkura”, poezi,”Qendra e kulturës”, Kastriot, 2010.
18.”Stuhi në Kutulishte”, poezi, ”Qendra e kulturës”, Kastriot, 2010.
19. “Posa ikte nata”, poezi, “Qendra e kulturës “, Kastriot, 2010.
20. “Loja e myshqeve”, poezi,”Qendra e kulturës”, Kastriot, 2010.
21. ”Lumëbardhi dhe gjëma”, poezi,”Qendra e kulturës”, Kastriot, 2010
22. “Metafora e heshtjes”, poezi, “Qendra e kulturës”, Kastriot, 2010
23. ”Hyji në Prekaz”, poezi,”Qendra e Kulturës”, Kastriot, 2010.
24. ”Sinorët e hinores”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot 2010.
25. ”Don Kishoti dhe Rosinanti”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2010
26.”Zjarri i dashurisë”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2010
27. ”Kur likenet vallëzojnë”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2010
28. “Ditari në vargje”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2010
29. “Tingujt që nuk përfundojnë”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2010.
3o.“Shtegu i mallit”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2010
31. ”Korniza e thyer”’, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2010

32. “Zgjimi i gjëmës”, Poezi, Shoqata e Shkrimtareve, Kastriot, 2010
33.“Vallja mistike”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2010
34. ”Merre kodin”, Poezi për fëmijë, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2011
35.“Letër atdheut” poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2011
36. “Tejdukshmëria e shiut”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2011
37. “ Përtej teje”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2011
38. “Sa afër e sa larg”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2011
39. “Vallja e zanoreve”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2011
40. “Ikja e eshtrave”, Poezi për të rritur, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2011
41.”Kalorësit e mjegullave”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
42. “Hingëllimat e shiut”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
43. “Kur pemët i ndërrojnë këmishët”. Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
44. “Mirëmëngjes Imzot”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
45. “Kafshimi i mikut”, Poezi satirike, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
46. “Atje tej maleve”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve , Kastriot, 2012
47. “Heshtja që del në shesh,” Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012

48. “Portat e shpresës”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
49. “Në dhomën time gjysmë të errët”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
5o. “Kinse Lojë Shahu”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
51. “ Për çdo dekadë nga një baladë “, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
52. “Fusha e mëllenjave”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
53. “E kujt është kjo vetmi”, Poezi, Shoqate e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
54. “Mos pyet për adresën e lumit”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
55. “ Stoli në parkun vjetër” Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
56. “Urori i stralltë”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
57. “Po të mos ishte fjala”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot,2012
58. “Thyerja e urave”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
59. “ Trokëllimat në gjumin e dallgëve”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
60. “ Në flokët e dëborës”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
61. “Një grusht nostalgji”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
62. “ Kur filluan të flasin njerëzit”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
63. “Kur stinët kapërcejnë fshehurazi”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012

64. “ Lisi në rrënjët e veta” , Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot 2012
65. “Eca ecëm dhe do ecim”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
66. “Fëmijët e erës”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot 2012
67. “ Çast në fund të stinës”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
68. “Si të flas me drurët”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
69, “ Më pëlqejnë mendimet e tua”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot , 2012
70. ”Andej dhe këndej kohës”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot , 2012
71. “Zëri i heshtjes”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
72. “Kush i lexoi letrat prej erës”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
73. “ Fluturimi i korbave në netët pa hënë”, prozë poetike, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
74. “Koha e ime dhe koha e jote”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot , 2012
75.” Diku te një baladë”, Poezi, Shoqate e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
76. “ Sonte çdo gjë po i përngjan lotëve”,Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
77 “ Ky def prej hëne”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
78.“Pyesni zogjtë në ikje ”,Poezi , Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”, Kastriot 2013
79 “ Fërfërimë gjethesh”, Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013

80. “Refrene yjesh”, Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013
81. “Te delta e mjellmave”, Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013
82.“Rinjohja”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013
83.“Diku në fund të një fillimi”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013
84.“Mëkati i hijes”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “ Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013
85.“Një zog prej uji”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013
86.”Asnjë fjalë nuk frymon”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014.
87.”Daullet e një nate”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
88.”Sytë e gurtë të erës”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
89.”Kur dehen perënditë”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
90. “Fjetëm njëqind shekuj” Prozë poetike, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014.
91.”Krakëllimat e natës”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
92. “Ndjekësit e enigmave”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
93. “Atdheu i paçmuar”Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “ Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
94.”Psalm i harruar ”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”Kastriot 2014
95,”Për kë po bie moj kambanë”, Poezi Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014

96. “Mbi flokët e ullukëve”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
97. “Menatë vijnë lejlekë”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
98. “Loti i gotës së dehur” , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
99. “Stina asnjanëse”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
100. “Dëneste bashkë me erën” Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
101. “Druri i pikëlluar”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
102. “Një grusht dashuri”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
103. “Lëreni zërin tim”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
104. “Shi në qytetin tim”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
105. “Si trenat e verbër ”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
106. “Zjarri i malli tim ”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
107. “Kur teshtin era”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
108. “Mbi shpirtin e erës pagane”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
109. “Nëpër gjymtyrët e mjegullave”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
110”Ajo nuk erdhi sonte” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015

111.“Një hënë e zhveshur”,Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
112. “Nëpër plasaritjet e mureve”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
113.“Mes telave gjembor ”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND” ,Prishtinë, 2015
114. “Të vizatosh një zog në mur”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
115.” Nuk flenë as kuajt e dehur” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
116.”Fluturojnë zogjtë e verbër ” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
117. “Një shi prej bryme” , Poezi, Shtëpia Botuese “TREND” , Prishtinë, 2015
118. “Në prehrin e pemëve” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND” , Prishtinë, 2015
119. “Zëri i largët i shiut ”, Poezi Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
120. “Yjet e ngrira të kujtesës ” , Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
121. “ Thirrmat e hijeve”, Poezi, Shtëpia Botuese”TREND”, Prishtinë, 2015
122. “Dritaret e verbëta ”, Poezi, Shtëpia Botuese”TREND”, Prishtinë, 2015
123 . “Përtej portave të mbyllura” , Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
124. “Malli i etjes” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
125. “Kur qajnë pemët ”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
126. “Të dielave në qytetin tim ”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016

127. “ Nëpër brigjet e kujtesës” Poezi,
Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
128. “Rrugës qante një stërqok”, Poezi,
Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
129. “Kali im prej bore” , Poezi, Shtëpia Botuese
“TREND”, Prishtinë, 2016
130. “Përballë hijes së mollës ”, Poezi,
Shtëpia Botuese “TREND “, Prishtinë, 2016
131. “Jehu i zërave”, Poezi,
Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
132. “Në kujtesën e pemëve ”, Poezi,
Shtëpia Botuese “TREND “, Prishtinë, 2016
133.“Më mirë një gjysmë ëndrre ”, Poezi, Shtëpia
Botuese “TREND “, Prishtinë, 2016
134.“Një dry prej dylli ” Poezi, Shtëpia Botuese
“TREND”, Prishtinë, 2016.
135.“ Në anën tjetër të mendjes”, Poezi, Shtëpia
Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
136.“Sa shumë ethe pat dimri sivjet”, Poezi, Shtëpia
Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
137. “Enigmat e kashelashave ”, Poezi, Shtëpia
Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
138. “Nuk i them uinë dot kësaj liri” , Poezi,
Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
139. “Fluturat prej letre ”, Poezi,
Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
14O. “Fluturimi i gjinkallës”, Poezi, Shtëpia Botuese
“TREND”, Prishtinë, 2016
141.“Kumritë prej deltine”, Poezi, Shtëpia Botuese
“TREND”, Prishtinë. 2016
142.“Më pritni te baladat e gurit”, poezi, Shtëpia
Botuese “TREND”, Prishtinë, 2017.

143.“Trenat këtu gjithmonë vonohen”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë. 2017
144.“Lulëzojnë gjethet e ullinjve”, poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2017
145.“Teatri antik i kujtesës”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë. 2017
146.“Portreti i lirisë”, poezi, Shtëpia Botuese TREND”, Prishtinë, 2017
147.“Një stinë delikate”, poezi, Shtëpia Botuese TREND”, Prishtinë, 2017
148.“Te ullishtat e vjetra ”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë. 2017
149.“Ishim të lumtur si gjinkallat”, poezi, Shtëpia Botuese TREND”, Prishtinë, 2017

PËRMBAJTJA:

Cikli i parë
Njeriu gjithmonë përsëritet.....23

Brenda meje çmenden muret.....25
Po bie si trishtimi.....26
Me dorën e djathtë ta preki diellin.....27
Sonte po i ngjajnë harresës.....28
Brenda mureve të mykura.....29
Kurse e nesërmja askund në horizont.....30
Sërish të lehurat e pandalshme.....31
Njeriu gjithmonë përsëritet.....32
Shoh maska të të gjitha llojeve.....34
Nëpër fusha lulëzuan bozhuret.....35
Kush i preu drurët halor.....36
Diku në vaun e kujtesës.....37
E marrim dynjanë në sy.....38
Pemët rëndohen nga drynat.....39

Pasi që të vegjlit u rritën.....40
Pa lejlek qyteti duket i vdekur.....41
Kolliten me një zë asnjanës.....42
Ju thashë jashtë asnjë njeri.....43
Ti nuk ishe askund mes gjetheve.....44
S'pushonin tingujt e një serenate.....45
Nga një krismë prej fjale.....46
Dikur vonë kur këndellen.....47
Lexo sa të duash biografinë tënde.....48

Cikli i dytë

Këta lisa e këta rrape.....51

Më duket se kishe ikur.....53
Bisedojmë me etërit për kohën.....54
Presin zërin e atdheut.....55
Sa herë që i shfletoj librat e vjetër.....56

Gjithmonë ishim fajtorë kujdestarë.....57
Me duket se edhe vet e patëm fajin.....58
Ishte dikur moti kjo mbrëmë.....59
Prina sa nuk është vonë.....60
Përkundi dhe rriti nga një plis.....62
Më shumë se asnjëherë dhembje.....64
Këta lisa e këta rrape.....66
Unë kurrë nuk i besova qeshjes.....68
Shikojmë rreth nesh brymën.....69
Kurse me tjetrën.....70
Përreth fëmijët lozin pa brenga.....71
Paskan një pamje të verbër.....72
As me mungesën e nënës.....73
Për këtë qytet fantazmë.....74
Pranë portretit të pagjumësisë.....76
Po ashtu edhe historia shtrigë.....77
Si një lloj relikti të paçmuar.....78

Udhëtarët e së nesërmes.....79
Ata të përdatur kërkonin vetëm numër.....80
Aq më shumë armë për të sotmen.....81
Shkofshi në dreq të mallkuar.....82

Cikli i tretë
Ishim të lumtur si gjinkallat.....84

Tmerrësisht ndjej mungesën tënde.....86
Sërish trokita te retë.....87
Nëse duam ta zëmë trenin e dashurisë.....88
Sa që të ngufat aty për aty.....89
Po dënes celulari në heshtja.....90
Disa pohuan se është dimër.....91
Gruaja dhe stina.....92
Ditën kur u pamë.....93
Ishim të lumtur si gjinkallat.....94

Por më kujtohen kohërat e mira.....95
Lulet më të bukura.....96
Si librat e vjetër i shfletoj kujtimet.....97
Po nuk erdhe ti ato kurrë nuk hapen.....98
Në cilën ëndërr u fundose.....99
Kur afrohet koha e ikjes.....100
Patëm një tjetër ndjenjë.....101
Gjithmonë dashurove vetëm një stinë.....102
Kur u ngjyrosëm mëngjeset.....103
Nëse ti më mungon.....104
Puthjet.....105

Katalogimi në botim – **(CIP)**

Biblioteka Kombëtare e Kosovës
"Pjetër Bogdani"

821.18-1

Zaplluzha, Adem

Ishim të lumtur si gjinkallat / Adem Zaplluzha. – Prishtinë : "Trend", 2017. – 120 f. ; 20 cm.

ISBN 978-9951-694-84-1